VENDIM
Nr. 74, datë 7.2.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 307, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR REGJISTRIMIN DHE IDENTIFIKIMIN E PERSONAVE TË SIGURUAR NGA SIGURIMI I DETYRUESHËM SHËNDETËSOR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27, pikat 5 e 6, dhe 41, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 8, e vendimit nr. 307, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, riformulohet, si më poshtë vijon:

"8. Identifikimi i personave të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor bëhet me anë të dokumentit të identifikimit, nëpërmjet shërbimit të regjistrit elektronik të të siguruarve të fondit ose portalit e-Albania.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama